



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 536 Akti

Nr. 582 Vendimi  
Tiranë, më 2.11.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 31.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Nurjeta Pogaçe (Tafa)**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa), me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2020 zhvilloi procedurën e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjyqësor të datës 19.6.2020 u caktua me mirëkuptim si kryesues komisioneri Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**12.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit është zhvilluar duke kryer një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 11.10.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.10.2022 u njoftua nëpërmjet postës elektronike, me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit, mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë një afat kohor i arsyeshëm, deri në datën 21.10.2022, për të paraqitur shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit, edhe pse u njoftua nga Komisioni, nuk e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen dhe për të administruar kopje të saj.

**16.** Në datën 21.10.2022 subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja (nëpërmjet postës elektronike dhe depozitimit në protokollin e Komisionit).

---

<sup>1</sup> Akti i përfundimit të kontrollit nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë<sup>2</sup> subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, i cili u ftua me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 31.10.2022.

## II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa) u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 31.10.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

19. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Nurjeta Pogaçe (Tafa) ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, objektivitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>3</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të

<sup>2</sup> Subjekti u njoftua nëpërmjet adresës elektronike të datës 26.10.2022.

<sup>3</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**21.6.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**22.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

**22.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duke e krahasuar me deklaratimet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në ILDKPKI, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

**22.2.** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive.

**22.3.** Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**23. Pasuria e llojit “shtëpi banimi”,** me sipërfaqe totale 443.83 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi me pjesëtarët e tjerë të familjes, me pjesë takuese 1/6 ose 16.6%. Në lidhje me vlerën e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se për shkak të përfitimit me trashëgimi ligjore nuk është në dijeni të përcaktimit të ndonjë vlere të shtëpisë.

---

*i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.*

**23.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përfitimin me trashëgimi ligjore, pasi babai i saj ka ndërruar jetë.

### **23.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite dhe gjatë hetimit administrativ**

- i. Në deklaratën e interesave privatë përpara fillimit të detyrës të vitit 2013<sup>4</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shtëpi banimi, përfituar me anë të trashëgimisë nga babai, pjesa takuese 16.6 %”*.
- ii. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka deklaruar si adresë në deklaratat e pasurive që nga fillimi i detyrës dhe deri në vitin 2016 adresën ku ndodhet pasuria objekt vlerësimi.
- iii. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>5</sup> se ka bashkëjetuar në këtë pasuri me familjarët e saj, që nga lindja dhe deri në momentin e fillimit të bashkëjetesës me bashkëjetuesin e saj A.P në vitin 2017.

**23.3. Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:** *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.*

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me këtë pasuri**

**24.** Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë<sup>6</sup> (në vijim ZVRPP) ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në bashkëpronësi në emër të subjektit të rivlerësimit, të nënës së saj E. T, të motrës së saj H.T dhe të tre vëllezërve E.T, I.T dhe K.T, me pjesë takuese nga 1/6 secili.

**24.1.** Nga administrimi i akteve të depozituara në regjistrin e ZVRPP-së ka rezultuar se pasuria objekt vlerësimi është përfituar me trashëgimi nga babai i subjektit, i ndjeri P. T, i cili rezulton se e kishte blerë me kontratën e shitjes<sup>7</sup> datë 22.4.1931 dhe pas ndërrimit të jetës së tij pasuria objekt vlerësimi është ndarë midis bashkëshortes dhe fëmijëve, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.11.1975, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të rezultuar në dosjen e regjistrimit, pasuria i është nënshtruar disa saktësimeve teknike të sipërfaqeve (oborr dhe ndërtesë), për shkak të ekzekutimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 4.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**24.2.** Nga analizimi i këtyre akteve në koherencë me njëra-tjetrën në lidhje me fitimin e pronësisë, përfshirë edhe saktësimin e sipërfaqeve ndër vite, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar saktë pasurinë, pasi referuar akteve shtëpia e banimit (ndërtesa) mbi të cilën subjekti dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë rezultuan bashkëpronarë përfaqësonte një sipërfaqe rreth 177 m<sup>2</sup>, ndërsa pjesa tjetër që mbetej ishte oborr me sipërfaqe 266.35 m<sup>2</sup>. Bazuar në këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**25.** Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën e pasurisë ka deklaruar funksionin e pasurisë si “shtëpi banimi” dhe se ka pasur për qëllim të deklarojë sipërfaqen totale 443.83 m<sup>2</sup>. Subjekti ka sqaruar se deklarimin e ka bazuar në dokumentin zyrtar, që ka qenë certifikata për vërtetimin e pronësisë dhe se nuk është marrë personalisht me regjistrimin e pasurisë. Gjithashtu ka shpjeguar se për regjistrimin e kësaj pasurie janë hapur disa kartela pasurie, të cilat, me hartimin e një plan rilevimi të ri, kanë sjellë nevojën e mbylljes së tyre dhe bashkimin në një pasuri të

<sup>4</sup> Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 13.1.2014.

<sup>5</sup> Shihni pyetësorin nr. \*\*\*.

<sup>6</sup> Shihni praktikën e mbajtur nga Komisioni me ASHK-në: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2020; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2022, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri, si dhe dokumentacionin e administruar nga dosja e ILDKPKI-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2018, të ZVRPP-së Tiranë.

<sup>7</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

vetme që është pasuria nr. \*\*\*. Pasuria që rezulton e regjistruar aktualisht është vetëm pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe totale 443.83 m<sup>2</sup>, nga të cilat 142 m<sup>2</sup> janë ndërtim.

**25.1.** Nga i gjithë shpjegimi më lart, subjekti ka konkluduar para Komisionit se mospërputhja midis sipërfaqes së ndërtimit, të përcaktuar në vendimin gjyqësor, me sipërfaqen e ndërtimit që rezulton e regjistruar mund të jetë objekt i një procesi administrativ dhe/ose gjyqësor në të ardhmen dhe nëse do të rezultojë se në të vërtetë sipërfaqja e ndërtimit është 177 m<sup>2</sup> dhe jo 142 m<sup>2</sup>, ky fakt do të deklarohet prej saj në deklaratën përkatëse periodike.

**25.2.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit i ka komunikuar Komisionit ndryshimet në pjesën e saj takuese në këtë pasuri për shkak të ndërrimit jetë të nënës së saj E.T. Për të sqaruar këtë para Komisionit, subjekti paraqiti<sup>8</sup> certifikatën e regjistrimit të pronësisë të lëshuar në datën 21.9.2021, sipas së cilës rezulton po e njëjta sipërfaqe (truell 443.83 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 142 m<sup>2</sup>), si dhe kartelë pasurie, sipas së cilës rezulton se pjesa takuese e nënës së subjektit i ka kaluar vëllait të subjektit, i cili gëzon 2/6 pjesë takuese.

**25.3.** Në përfundim, subjekti ka konkluduar se për sa ka sqaruar më lart vlerëson se nuk ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë. Për të provuar në lidhje me shpjegimet e saj, subjekti paraqiti dokumentacionin tekniko-ligjor në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**26.** Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të paraqitura me shkrim dhe në seancën dëgjimore, si dhe shqyrtoi provat e paraqitura, vlerëson se subjekti arrin një nivel të bindshëm në deklaramin e sipërfaqes së plotë të pasurisë, bazuar në certifikatën e regjistrimit të pasurisë.

**26.1.** Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti konstatohet se vendimi nr. \*\*\*, datë 4.4.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Më vonë pasuria ka pësuar disa ndryshime për shkak të rivlerësimeve teknike nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në përfundim, pasuria është regjistruar me këto të dhëna: truell me sip. 443.83 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 142 m<sup>2</sup>. Fakti i mospërputhjes së sipërfaqes së ndërtesës sipas vendimit të gjykatës me certifikatën e pasurisë nuk e penalizon subjektin, për sa konstatohet se deklarimi i pasurisë është bazuar në aktin publik të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

**26.2.** Trupi gjykues konkludon se subjekti arriti të shpjegojë plotësisht mbi bazën e provave se nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për deklaram të saktë dhe të plotë, për sa kohë që deklaramin e ka bazuar në dokumentacion justifikues, sikurse kërkohet në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe se mospërputhjet e sipërfaqeve të pasurisë të konstatuara gjatë hetimit mbeten çështje të karakterit teknik, të cilat nuk ndikojnë në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

### **27. Pasuria e llojit “automjet”**

**27.1.** Automjet tip “\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, benzinë + gaz (kjo e fundit në vitin 2015). Pjesa takuese: 100%. Vlera: 500.000 lekë (çmimi i shitjes + vlera e montimit të impiantit të gazit).

**27.2. Si burim krijimi** subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerë nga kursimet e familjes (përfshirë edhe të ardhurat e realizuara nga ana ime), si shpërblim për mbarimin e Fakultetit të Drejtësisë me ‘medalje ari’”*

---

<sup>8</sup> Akte të printuara nga sistemi *e-albania* të vulosura në mënyrë dixhitale.

## **Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite**

**27.3.** Subjekti ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013<sup>9</sup>, me përshkrimin “automjet \*\*\*, me targa AA \*\*\*, blerë nga kursimet e familjes”.

**27.4. Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:** *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*

### **Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**27.5.** DPSHTRR-ja<sup>10</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në pronësi të saj në datën 5.7.2011 automjetin me targa AA \*\*\*. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti është konstatuar se është blerë fillimisht nga vëllai i subjektit E.T në vitin 2008 në Itali dhe pas kryerjes së procedurave të zhdoganimit, me kontratën e shitblerjes<sup>11</sup> të datës 4.7.2011, ia ka shitur këtë automjet subjektit të rivlerësimit kundrejt vlerës 500.000 lekë.

**27.6.** Komisioni kreu analizën financiare<sup>12</sup> në lidhje me mundësitë e subjektit për të përballuar kryerjen e shpenzimeve në vlerën 58.000 lekë në vitin 2015 për implementimin e pajisjes së impiantit të gazit në automjet, bazuar në deklarin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ<sup>13</sup>.

**27.7.** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përfituar nga hetimi dhe se subjekti ka pasur mundësi financiare për të përballuar me të ardhura të ligjshme kryerjen e shpenzimeve për implementimin e impiantit të gazit në automjetin objekt vlerësimi, për të përballuar shpenzimet jetike, si dhe krijimin e likuiditeteve bankare gjatë vitit 2015.

## **28. Pasuria e llojit “likuiditet bankar”, llogari detyrimesh *overdraft* dhe kartë krediti**

**28.1. Llogari page në “Alpha Bank” në vlerën 15.540 lekë.** Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar këtë llogari për herë të parë në DIPP/2015, ndërsa në DIPP/2016 ka deklaruar gjendje të mbetur.

**28.1.1. Si burim krijimi** subjekti ka deklaruar gjendjen e mbetur nga kalimi i pagesës së muajit dhjetor 2016 (llogari aktive).

**28.2. Limit *overdraft* në shumën 240.000 lekë.** Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar këtë detyrim në DIPP/2016.

**28.2.1. Si burim krijimi** të këtij detyrimi subjekti ka deklaruar: “Çelur në vitin 2016 pranë ‘Alpha Bank’ (i akorduar, por i patërhequr)”.

**28.3. Kartë krediti VISA,** me vlerë 150.000 lekë, e pashpenzuar. Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar kartën e kreditit në DIPP/2016 në të njëjtën vlerë.

**28.4. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në vlerën 0 (zero) lekë** (llogari aktive). Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar këtë llogari në DIPP/2015 me burim të ardhura nga shërbimi i ofruar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të reformës në drejtësi.

<sup>9</sup> Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 13.1.2014.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Kontratë shitblerjeje (pasuri e luajtshme) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.7.2011, redaktuar nga noteri publik Sh.Gj.

<sup>12</sup> Shihni tabelën financiare për periudhën vjetore 2013 – 2016, aneksi nr. \*\*\*.

<sup>13</sup> Referuar faturës tatimore të shitjes nr. \*\*\*, datë 9.12.2015, pjesë e dosjes së ardhur nga DPSHTRR-ja.



**28.4.1. Si burim krijimi** subjekti ka deklaruar bursën nga Shkolla e Magjistraturës dhe depozitim nga fondacioni “S” si financues i shërbimit të ofruar si eksperte e nivelit të mesëm pranë Kuvendit në kuadër të reformës për sistemin e drejtësisë për vitin 2015.

**28.5. Llogari rrjedhëse në “ProCredit Bank” në vlerën 0 (zero) lekë** (llogari e mbyllur). Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar këtë llogari në DIPP/2015 me gjendje deri në datën 31.12.2015, e mbartur nga gjendja e një viti më parë, me burim nga paga si lektore e jashtme nga A.U.

**28.5.1. Si burim krijimi** subjekti ka deklaruar bursën nga Fakulteti i Drejtësisë, kalim page nga A.U dhe pagesa të tjera.

**28.6. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në vlerën 0 (zero) lekë** (llogari e mbyllur). Pjesa takuese: 100%. Subjekti e ka deklaruar këtë llogari në DIPP/2015 me gjendje deri në datën 31.12.2015, me burim kalim page nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**28.6.1. Si burim krijimi** subjekti ka deklaruar pagën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në datën 30.9.2015.

**28.7. Konstatimi i ILDKPKI-së për llogaritë në tërësi:** *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e ardhura nga bankat.*

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto llogari**

**28.8.** Komisioni kreu hetim të pavarur për secilën nga llogaritë<sup>14</sup>, nga ku rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e siguruar nga hetimi administrativ.

**29. E drejtë përdorimi e një shtëpie banimi**, me adresë: Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\* ”, pallati mbrapa Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kati \*\*\*, marrë me qira nga bashkëjetuesi i subjektit A.P, sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2017, i cili ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar se ka të drejta reale përdorimi dhe banimi që burojnë nga kjo kontratë.

**29.1.** Komisioni ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në lidhje me këtë deklaram, ku vërehet se në datën 17.11.2007 është lidhur kontrata e sipërmarrjes midis shoqërisë “\*\*\*\*” dhe shtetasit L.M, për porositjen e një banese me sip. 85 m<sup>2</sup> gjithsej, e ndodhur në katin e nëntë të një pallati që do të ndërtohet në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës. Në vijim, në datën 23.1.2017 është lidhur kontrata e qirasë<sup>15</sup> midis shtetasit L.M, në cilësinë e qiradhënësit, dhe bashkëjetuesit të subjektit A.P, në cilësinë e qiramarrësit.

**29.2.** Nga administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të siguruar nga hetimi nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme në kuptim të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit.

#### **Personat e lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016**

**30.** Në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *“Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit..., si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.*

<sup>14</sup> Shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020, e “Alpha Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, e “Alpha Bank” në dosjen e ILDKPKI-së; nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020; nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2020, e “ProCredit Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020; nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2020, e “Credins Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020.

<sup>15</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

**30.1.** Në nenin 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: “*Periudha e rivlerësimit është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij*”. Sipas këtij ligji dhe referuar pikës 3 të nenit 41, kjo periudhë përkon me 3 vitet e fundit nga hyrja në fuqi e tij. Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016.

**30.2.** Më tej, në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “*Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij*”.

**30.3.** Bazuar në këto dispozita ligjore, periudha e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, për efekt të këtij ligji është nga data 8.10.2013 (kohë e cila përkon edhe me fillimin e ushtrimit të detyrës) deri në datën 8.10.2016. Referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit konstatohet se për periudhën nga fillimi i detyrës dhe deri në vitin 2015, subjekti ka deklaruar si persona të lidhur nënën e saj, të ndjerën E.T dhe 3 vëllezërit, përkatësisht: E.T, I.T dhe K.T.

**30.4.** Referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën *Vetting*, deklaratimet periodike vjetore, si dhe bazuar në hetimin administrativ të Komisionit<sup>16</sup> në lidhje me gjendjen e trungut familjar të subjektit për periudhën e rivlerësimit, Komisioni kreu hetimin administrativ në lidhje me personat e lidhur E.T, E.T, I.T, K.T dhe A.P. Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan pasuri të tjera nga ato të deklaruara nga personat e lidhur, i vëllai K.T dhe bashkëjetuesi A.P.

**30.5.** Gjatë hetimit administrativ për personat e lidhur, Komisioni e ka pyetur subjektin<sup>17</sup> në lidhje me to, si dhe i ka kërkuar të deklarojë dhe të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të tyre në lidhje me detyrimet financiare, interesat privatë të tyre, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar<sup>18</sup> se: “*Edhe pse vlerësoj se vëllezërit e mi nuk janë persona të lidhur materialisht me mua dhe nuk kanë pasur detyrimin për plotësimin e deklaratës së pasurisë, por e kanë plotësuar në kushtet e mungesës së një interpretimi dhe për të evituar çdo lloj dyshimi, sqaroj se lidhur me këtë pyetje i kam kërkuar vëllait që disponon pasuri veçmas dokumentacionin e nevojshëm, për aq sa kërkohet nga ana juaj dhe jam në pritje të paraqitjes së tij*”. Në vijim<sup>19</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në lidhje me pasuritë e vëllait K.T, të deklaruara në deklaratën *Vetting* si pasuri të luajtshme.

**30.6.** Lidhur me burimin e të ardhurave, subjekti ka sqaruar se, referuar deklaratimit të vëllait, pasuritë e luajtshme kanë pasur si burim kursimet nga puna e tij si inxhinier mekanik-elektronik, meqenëse ka qenë i vetëm dhe nuk ka pasur persona të tjerë në ngarkim për të cilët duhej të përgjigjej financiarisht. Sikurse ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë, të ardhurat janë realizuar nga ofrimi i shërbimeve në fushën e mekanikës/elektronikës dhe jo të punësimit me kohë të plotë dhe i siguruar.

**30.7.** Subjekti ka paraqitur disa dokumente, kryesisht në formën e vërtetimeve, lëshuar nga disa shoqëri tregtare, për të vërtetuar bashkëpunimin që ka pasur vëllai i saj në periudha të ndryshme me disa shoqëri<sup>20</sup>, si vijon: vërtetim nga personi fizik “\*\*\*\*”, me emër tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k., me

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2022.

<sup>17</sup> Pyetja nr. \*\*\* e pyetësorit të dytë.

<sup>18</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. \*\*\*, të dërguar në datën 21.6.2022 nëpërmjet postës elektronike përkatëse, në të cilën është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit.

<sup>19</sup> Nëpërmjet postës elektronike të datës 7.7.2022.

<sup>20</sup> (i) Vërtetim datë 23.6.2022, nga personi fizik “\*\*\*\*”, me emër tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k., me NUIS \*\*\*, sipas të cilit citohet se vëllai ka pasur një bashkëpunim me këtë biznes për periudhën 2002 – 2007, në sektorin e riparimit/shërbimit të pajisjeve, në formën e ofrimit të shërbimeve kundrejt shpërblimit. Sipas këtij vërtetimi referohet se shërbimi për riparimin/shërbimin e pajisjeve varionte nga 2.000 deri në 10.000 lekë dhe gama e

NUIS \*\*\*, datë 23.6.2022; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2008, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; vërtetim datë 30.6.2022, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me emër tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*; vërtetim datë 1.7.2022, nga personi fizik “\*\*\*\*”, me emër tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2022, nga K.P.T.

**30.8.** Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se të ardhurat e përfituara nga vëllai i saj K.T janë më shumë se ato të cituara në vërtetimet që ka mundur të sigurojë ai, duke cituar, ndër të tjera, shërbimet e ofruara në fushën e elektro-mekanikës në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, për mirëmbajtjen e ashensorëve apo në subjektet që iu ka ofruar shërbimin e montimit të impianteve të gazit, duke paraqitur si provë fotokopje të aktit në gjuhë të huaj, certifikatë datë 15.3.2016, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*”, në emër të z. K.T për trajnimin e tij në kryerjen e këtyre shërbimeve teknike.

**30.9.** Komisioni administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga vëllai i saj K.T, por nga analizimi nuk u evidentua realizimi i të ardhurave mbi të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Ky konstatim ka rezultuar edhe nga hetimi i Komisionit, ku nuk evidentohet që personi i lidhur me z. K.T të ketë përfituar të ardhura të deklaruara dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, përveç periudhës mars 2016 e në vijim, referuar informacionit të marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore<sup>21</sup>, të ardhura që janë konsideruar në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën kur kanë qenë të lidhur brenda të njëjtit trung familjar.

#### **A. Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur K. T në deklaratën *Vetting***

**31. Automjet tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 1998, blerë në datën 20.1.2016 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 185.000 lekë.**

**31.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij dhe të familjes.

**32. Automjet tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 1999, blerë në datën 5.4.2014, në shumën 2.200 euro.**

**32.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij (të ardhura të krijuara nga puna profesionale si inxhinier mekanik dhe elektronik).

**33. Automjet tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 1995, blerë në datën 13.5.2013 (blerë para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit) në shumën 160.000 lekë.**

**33.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij.

---

produkteve ka qenë e gjerë duke paraqitur për këtë deklaram edhe vërtetimin tjetër të datës 24.3.2016, lëshuar po nga “\*\*\*\*” sh.p.k. në lidhje me gamën e produkteve elektronike të disponuara nga personi fizik për një periudhë 10-vjeçare; (ii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2008, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas së cilës citohet se z. K.T është punonjës i kësaj shoqërie *part-time* dhe një vërtetim sipas të cilit vërtetohet derdhja e kontributeve nga shoqëria për këtë shtetas për periudhën mars 2008 – gusht 2008, në total shumën 146.403 lekë; (iii) vërtetim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me emër tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*, datë 30.6.2022, sipas të cilit citohet se z. K.T ka pasur një bashkëpunim me këtë shoqëri tregtare për periudhën 2009 – 2015, në ofrimin e shërbimeve në sektorin e riparimit të pajisjeve kompjuterike kundrejt shpërbllimit në shumën rreth 300.000 lekë; (iv) vërtetim nga personi fizik “\*\*\*\*”, me emër tregtar “\*\*\*\*”, me NUIS \*\*\*, datë 1.7.2022, sipas të cilit citohet se vëllai i subjektit ka pasur një bashkëpunim me këtë biznes për periudhën qershor 2015 – dhjetor 2015. Shuma e përfituar ka qenë 300.000 lekë; (v) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2022, nga K.P.T, sipas të cilit rezulton se nga viti 2016 z. K.T është i punësuar me kohë të plotë në cilësinë e stafit akademik në departamentin e elektro-mekanikës, si dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2022, i lëshuar nga K.P.T, sipas të cilit rezulton se paga mujore *bruto* është 100.396 lekë, ndërsa paga mujore *neto* 80.000 lekë.

<sup>21</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2022.

**34. Motoçikletë tip “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, blerë në datën 8.7.2013 (para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit) në shumën 300 euro.**

**34.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij.

**35. Automjet tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 1991, blerë në datën 17.11.2011 (para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit) në shumën 50.000 lekë.**

**35.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me mjetet motorike dhe analiza financiare**

**36.** Nga hetimi i Komisionit<sup>22</sup>, DPSHTRR-ja konfirmon regjistrimin e pasurive të luajshme deklaruar nga personi i lidhur K.T.

**37. Automjet tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 1991, blerë në datën 17.11.2011 (para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit) në shumën 50.000 lekë.**

**37.1. Si burim krijimi** personi i lidhur ka deklaruar kursimet e tij.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me mjetet motorike dhe analiza financiare**

**38.** Nga hetimi i Komisionit<sup>23</sup>, DPSHTRR-ja konfirmon regjistrimin e pasurive të luajshme, deklaruar nga personi i lidhur K. T.

**38.1.** Në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka përfshirë edhe investimet e vëllait të saj si person i lidhur me të, për blerjen e automjeteve gjatë periudhës së rivlerësimit. Analiza financiare u krye për dy pasuri të luajshme, të evidentuara të blera gjatë kësaj periudhe për automjetin tip “\*\*\*\*”, blerë në datën 20.1.2016 dhe automjetin tip “\*\*\*\*” model “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, blerë në datën 5.4.2014, paraqitur në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 1**

	<b>2014</b>	<b>2016</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>883,608</b>	<b>-900,181</b>
Automjet i llojit “****”, me targa AA ***	308,242	
Automjet i llojit “****”, me targa AA ***		185,000
Ndryshim likuiditeti	575,366	-1,085,181
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>883,608</b>	<b>-900,181</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>1,345,938</b>	<b>1,708,655</b>
Të ardhura nga paga e subjektit si pedagoge në A. U	90,000	
Të ardhura nga paga e subjektit si gjyqtare	989,886	1,051,122
Të ardhura nga pensioni/invaliditeti, nëna e subjektit	266,052	259,452
Të ardhura nga paga, vëllai i subjektit (K. T)		398,081
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>727,247</b>	<b>1,770,822</b>
Shpenzime minimale jetike	659,994	822,822
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	67,253	
Shpenzime mjekësore		948,000
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-264,917</b>	<b>838,014</b>

**38.2.** Referuar analizës financiare, subjekti dhe personi i lidhur me të rezultuan me pamundësi financiare në vlerën -264.917 lekë për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, model “\*\*\*\*” në vitin 2014, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera në këtë vit.

<sup>22</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2022.

<sup>23</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2022.

**38.3.** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit paraprak financiar në lidhje me balancën negative në vlerën 264.917 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**39.** Subjekti ka shpjeguar se vëllai nuk ka qenë i punësuar, por ka ofruar shërbime të ndryshme referuar faktit që ka qenë në shkollë dhe duhej të kujdesej edhe për nënën. Ajo ka theksuar se nga ana e të vëllait nuk është bërë asnjë përpjekje për të krijuar burime pasurie të paqena, por është bazuar në atë që ka ndodhur realisht: ofrimin e shërbimeve kundrejt pagesës.

**39.1.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar më tej se subjektet që kanë lëshuar vërtetimet dhe kanë pranuar faktin se vëllai u ka ofruar shërbime kundrejt pagesës dhe se përgjegjësia e mospagimit të detyrimeve duhet të bjerë mbi shoqërinë dhe nuk duhet ta penalizojë si subjekt, për sa kohë deklarimi i pasurisë nga ana e saj ka qenë i saktë dhe në përputhje me dokumentet përkatëse. Sipas subjektit, mbajtja e tatimit në burim është detyrim i punëdhënësit, pasi i vëllai ka ofruar shërbime me kontratë shërbimi, jo si i punësuar.

**39.2.** Si përfundim, subjekti ka kërkuar të zbatohet parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit në lidhje me procesin e rivlerësimit ndaj saj si parime të zbatuara gjerësisht në jurisprudencën e rivlerësimit.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**40.** Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit dhe në seancën dëgjimore, çmon se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me pamundësinë financiare në vlerën -264.917 lekë për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, model “\*\*\*” nga vëllai i saj në vitin 2014, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera në këtë vit.

**41.** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi përfitimin e të ardhurave të ligjshme të deklaruara dhe mbi të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të kryerjes së shërbimeve teknike elektro-mekanike nga vëllai i saj.

**41.1.** Komisioni, për të vërtetuar deklarinë e subjektit, verifikoi vërtetimet e paraqitura prej saj si provë, nga ku vërehet se referuar vërtetimit<sup>24</sup> datë 5.5.2008, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., z. K.T ka qenë punonjës i kësaj shoqërie me kohë të pjesshme për periudhën mars 2008 – gusht 2008, për të cilën citohet se janë derdhur kontributet. Referuar këtij vërtetimi vërtetohet se vëllai i subjektit ka qenë në marrëdhënie punësimi brenda një periudhe të shkurtër të vitit 2008, pra nuk rezulton i bazuar pretendimi i subjektit, pavarësisht se nga hetimi i Komisionit me të dhënat e disponuara<sup>25</sup> dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur prej saj, nuk rezultoi që për këtë periudhë të jetë kryer deklarimi për vëllain e subjektit në organin kompetent, si dhe të jenë paguar detyrimet tatimore të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

**41.2.** Gjithashtu, mbetet i pabazuar edhe pretendimi tjetër i subjektit se për shërbimet e kryera me kontratë detyrimi për pagesën e tatimit në burim është i shoqërisë. Referuar legjislacionit tatimor të kohës për periudhën objekt vlerësimi, neni 40 i ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 33, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se çdo person fizik/juridik mund të ushtrojë veprimtari ekonomik-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të cilët për shërbimin

<sup>24</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot. datë 5.5.2008

<sup>25</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2022, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë.

teknik të kryer janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën e përcaktuar me ligj nga shuma *bruto* e pagesës për shërbimin e kryer.

**41.3.** Trupi gjykues konkludon se, nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në raport me atë të rezultuar nga hetimi administrativ në lidhje me të ardhurat e përfituara nga vëllai i saj, si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e pamundësisë financiare, por duke e vlerësuar këtë pamjaftueshmëri në raport me rezultatin financiar në tërësinë e tij, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, çmohet si jorelevante në procesin e rivlerësimit ndaj subjektit dhe nuk e penalizon atë, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. Pasuritë e deklaruar nga personi i lidhur A. P në deklaratën *Vetting***

**42. Automjet tip “\*\*\*”,** viti i prodhimit 2001, ngjyrë blu, me targa AA \*\*\*, benzinë + gaz (janar 2016), blerë në vitin 2011 në vlerën 208.343 lekë nga familja mbi kontributin e dhënë nga paga e z. A.P, si vlerësim për arritjen në Shkollën e Magjistraturës.

**42.1.** Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave përpara fillimit të detyrës së personit të lidhur në vitin 2013, në vlerën 2.800 euro.

### **Verifikimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**42.2.** DPSHTRR-ja<sup>26</sup> ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të z. A.P. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti vihet re se personi i lidhur ka blerë automjetin në datën 13.11.2011 nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., kundrejt vlerës 208.343 lekë, si dhe janë paguar detyrimet doganore në vlerën 34.547 lekë. Në vijim, në datën 2.2.2016 është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të personit të lidhur A.P.

**42.3.** Nga administrimi i fakteve të rezultuara nga dokumentacioni u vu re se automjeti është përfituar nga personi i lidhur përpara fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk u thellua në hetime të mëtejshme.

### **43. Pasuritë e llojit “likuiditete”, të përbëra nga:**

- i. Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, me burim krijimi kalim burse nga Shkolla e Magjistraturës, pagim shume nga ish-përmbauesja A.S. Mbyllur në vitin 2016. Gjendje: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%.
- ii. Depozitë bankare në “Tirana Bank”, me burim krijimi kalim page nga DPM dhe kalim i shumës së detyrimit nga përmbauesi gjyqësor E.M. Mbyllur në vitin 2016. Gjendje: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%.
- iii. Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, me burim krijimi kalim page nga A. U dhe kalim i bursës nga Fakulteti i Drejtësisë për vitet 2005 - 2008. Mbyllur në vitin 2016. Gjendje: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%.
- iv. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, me burim krijimi nga paga në Prokurorinë e Rrethit Fier dhe llogari kursimi e hapur nga banka. Aktive. Gjendje: 0 (zero) lekë dhe 30.000 lekë në llogarinë e kursimit. Pjesa takuese: 100%.
- v. Depozitë bankare në BKT, me burim krijimi kalim page nga DPM, kryerje pagesash kartë krediti. Aktive. Gjendje: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%.

<sup>26</sup> Shihni dokumentacionin, pjesë e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2017, ardhur nga ILDKPKI-ja.

**43.1.** Nga hetimi i Komisionit në bankat e nivelit të dytë konfirmohen<sup>27</sup> llogaritë e personit të lidhur dhe nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme.

## **ÇËSHTJE TË TJERA**

**44. Apartament me sipërfaqe 54.76 m<sup>2</sup>,** ndodhur në R, në pronësi të prindërve të bashkëjetuesit të subjektit A.P, në përdorim për pushime verore.

**44.1.** Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar<sup>28</sup> se duke filluar nga viti 2017, në muajin gusht ka përdorur për pushime verore një apartament, i cili është në pronësi të prindërve të bashkëjetuesit A.P, duke paraqitur dokumentacionin justifikues certifikatë pronësie, lëshuar në datën 11.12.2017, për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*\*, ndodhur në R, Vlorë, me bashkëpronarë J.P dhe N.P, me pjesë takuese nga ½ secili.

### **Verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

**44.2.** Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit ka rezultuar se në datën 6.9.2014 nëna e bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje<sup>29</sup> me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin Gj. P.

**44.3.** Në datën 31.10.2014 prindërit e bashkëjetuesit të subjektit kanë lidhur një kontratë kredie<sup>30</sup> me “Tirana Bank”, me objekt “marrjen e një kredie në vlerën 4.000.000 lekë për një afat 8-vjeçar për blerjen e një apartamenti me sip. 60.78 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Vlorë”. Sipas kësaj kontrate referohet se për blerjen e këtij apartamenti kredimarrësit kanë parapaguar vlerën 15.000 euro. Për garantimin e kësaj kredie prindërit e bashkëjetuesit të subjektit kanë lidhur një kontratë hipotekore<sup>31</sup> me “Tirana Bank”, me objekt “sigurimin e kredisë në vlerën 4.000.000 lekë për blerje apartamenti në Vlorë”, duke lënë si garanci për pagimin e kredisë apartamentin në pronësinë e tyre me sip. 71.66 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Fier.

**44.4.** Në datën 14.11.2014 në llogari të babait të bashkëjetuesit është disbursuar kredia<sup>32</sup> në vlerën 4.000.000 lekë dhe shuma prej 3.891.000 lekësh i është transferuar brenda ditës shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**44.5.** Në datën 17.11.2017 prindërit e bashkëjetuesit të subjektit kanë lidhur kontratën e shitblerjes<sup>33</sup> me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe në datën 11.12.2017 pasuria apartament me sip. 54.76 m<sup>2</sup>, e ndodhur në R<sup>34</sup>, Vlorë, është regjistruar në emër të babait dhe nënës së bashkëjetuesit.

---

<sup>27</sup> Shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2021, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021; nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2021, e “Tirana Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021; nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2021, e “ProCredit Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021; nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021; nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2021, e BKT-së, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 24.3.2021.

<sup>28</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, pyetja nr. \*\*\*.

<sup>29</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.9.2014, në shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, të RNSH-së.

<sup>30</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2014, në shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020, të “Tirana Bank”.

<sup>31</sup> Kontratë hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2014, në shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020, të “Tirana Bank”.

<sup>32</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020, nga BKT-ja, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2020.

<sup>33</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2014, në shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, të RNSH-së.

<sup>34</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* është paraqitur certifikata e pronësisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 11.12.2017, për këtë pasuri me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në R, Vlorë, me bashkëpronarë J.P dhe N.P, me ½ secili.

**44.6.** Nga administrimi i fakteve të rezultuara nga dokumentacioni i siguruar gjatë hetimit u konstatua se apartamenti është porositur dhe paguar nga prindërit e bashkëjetuesit disa vite para fillimit të bashkëjetesës së z. A.P me subjektin e rivlerësimit dhe se nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit/personin e lidhur me të, në kuptim të kriterit pasuror.

**45. Apartament me sipërfaqe 106.4 m<sup>2</sup>,** ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëjetuesit të subjektit A.P.

**45.1.** Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>35</sup> se: “*Kam përdorur pasurinë apartament me nr. \*\*\*, në Tiranë, e cila ka qenë shtëpia e prindërve të bashkëjetuesit. Apartamenti nuk është përdorur në kuptimin e jetesës në të, por për të qëndruar me bashkëjetuesin*”. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues: certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 6.3.2020, për këtë pasuri me nr. \*\*\* vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me pronar shtetasin J.P.

### Verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**45.2.** Nga verifikimet e Komisionit ka rezultuar se në datën 26.9.2007 babai i bashkëjetuesit A.P, z. J.P, në cilësinë e blerësit, ka lidhur një kontratë shitblerjeje<sup>36</sup> me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, me objekt shitjen e një pasurie të llojit “apartament” me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 106.4 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkëta 7.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në pallatin “\*\*\*\*”, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, kundrejt vlerës 40.450 euro, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale. Në datën 6.3.2020 është lëshuar certifikata e pronësisë nr. \*\*\* për këtë pasuri me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 106.4 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit J.P.

**45.3.** Nga verifikimi i kryer rezultoi se pasuria është blerë nga prindërit e bashkëjetuesit përpara se subjekti i rivlerësimit të ketë filluar bashkëjetesën me z. A. P dhe, në këtë kuptim, Komisioni nuk u thellua në kryerjen e hetimeve të mëtejshme në kuptim të kriterit pasuror.

### ANALIZA FINANCIARE

**46.** Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën 22.10.2013 – 31.12.2013 dhe për vitet 2014 - 2016, paraqitur në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 2**

	22.10.2013 – 31.12.2013	2014	2015	2016
<b>A) PASURI</b>	<b>0</b>	<b>883,608</b>	<b>497,073</b>	<b>-900,181</b>
Automjetet i llojit “****”, me targa AA ***		308,242		
Automjetet i llojit “****”, me targa AA ***				185,000
Automjetet i llojit “****”, me targa AA ***			58,000	
Ndryshim likuiditeti		575,366	439,073	1,085,181
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>0</b>	<b>883,608</b>	<b>497,073</b>	<b>-900,181</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>151,111</b>	<b>1,345,938</b>	<b>1,689,976</b>	<b>1,708,655</b>
Të ardhura nga paga e subjektit si pedagoge në A.U	15,300	90,000		
Të ardhura nga paga e subjektit si gjyqtare	95,869	989,886	981,085	1,051,122
Të ardhura nga paga e subjektit si eksperte teknike pranë Kuvendit të Shqipërisë			449,439	

<sup>35</sup> Pyetësori nr. \*\*\*, pyetja nr. \*\*\*.

<sup>36</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.9.2007.



Të ardhura nga pensioni/invaliditeti, nëna e subjektit	39,942	266,052	259,452	259,452
Të ardhura nga paga, vëllai i subjektit (K.T)				398,081
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>81,137</b>	<b>727,247</b>	<b>672,828</b>	<b>1,770,822</b>
Shpenzime minimale jetike	81,137	659,994	672,828	822,822
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit		67,253		
Shpenzime mjekësore				948,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	69,974	-264,917	520,075	838,014

**46.1.** Nga analiza financiare paraprake dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar kryerjen e investimeve, shpenzimeve në vitin 2014, duke rezultuar me pamundësi financiare në vlerën -264.917 lekë.

**46.2.** Mbi bazën e rezultatit financiar paraprak, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**46.3.** Subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar në të njëjtën vlerë për blerjen nga vëllai i saj të automjetit tip “\*\*\*”, model “\*\*\*”, me targa AA \*\*\*.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**46.4.** Trupi gjykues thekson sërish për efekt të rezultatit financiar se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me pamundësinë financiare në vlerën -264.917 lekë për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, model “\*\*\*”, nga vëllai, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera përgjatë vitit 2014.

**46.5.** Komisioni konkludon se kjo pamjaftueshmëri financiare e subjektit të rivlerësimit, duke u vlerësuar në raport me rezultatin financiar në tërësinë e tij, si dhe duke u bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk e penalizon atë në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**47.** Në përfundim, nga vlerësimi tërësor i kriterit pasuror, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* është përpjekur të deklarojë saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe se pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit në lidhje me pasurinë e parë shtëpi banimi u sqaruan bindshëm prej saj.

**47.1.** Në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar në vitin 2014, në vlerën -264.917 lekë, kjo balancë negative është evidentuar për shkak të investimit për blerjen e një automjeti në vitin 2014 të vëllait të subjektit si person i lidhur me të. Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo pamundësi financiare për trupin gjykues është e atij niveli që nuk sjell penalizimin e subjektit, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**47.2.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**48.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**48.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, i përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht<sup>37</sup>, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**48.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa).

### Hetimi i Komisionit

**49.** Gjatë procesit të kontrollit të figurës, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seksionin “Të dhëna për sigurinë” të deklaratës për kontrollin e figurës, si vijon: *“Në vitin 2016 jam njoftuar verbalisht nga vëllai im I.T se ka pasur një proces penal në Milano, Itali, për posedim lëndë narkotike (neni 283 i Kodit tonë Penal), për të cilin është dënuar dhe ka vuajtur dënimin prej rreth 2 vjet e 6 muaj burgim në vitet shtator 2012 - mars 2015”*.

**49.1.** Mbi bazën e deklarimit dhe informacionit<sup>38</sup> të siguruar nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në lidhje me dënimin e vëllait të saj I.T, Komisioni ka kryer verifikimet përkatëse<sup>39</sup> në lidhje me gjendjen gjyqësore të këtij shtetasi, si dhe dënimet e dhëna ndaj tij në shtetet e huaja, kryesisht në shtetin italian.

**49.2.** Ministria e Drejtësisë informon<sup>40</sup> se nga verifikimet e kryera në regjistrin e gjendjes gjyqësore, shtetasi I.T rezulton i padënuar, duke dërguar bashkëlidhur edhe një kopje të vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2022, të gjendjes gjyqësore për këtë shtetas. Më tej<sup>41</sup>, Ministria e Drejtësisë informon<sup>42</sup> Komisionin në lidhje me gjendjen gjyqësore të shtetasit I. T, ardhur nga autoritetet italiane, si vijon:

- Referuar certifikatës së përgjithshme të gjendjes gjyqësore me nr. \*\*\*, datë 30.6.2022, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Romë, vërtetohet se ndaj shtetasit I.T është zbatuar vendimi i Gjykatës së Milanos, marrë formë të prerë në datën 4.2.2014, për tri vepra penale:

i. Vepra penale e parë “zotërim dhe shitje e paligjshme e lëndëve narkotike”, e kryer në datën 4.9.2012 në C.B dhe C.

<sup>37</sup> Deklasifikuar me vendim nr. \*\*\*, datë 14.6.2022, të KDZH-së.

<sup>38</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. \*\*\* të pyetësorit nr. \*\*\*.

<sup>39</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2022 dhe nr. \*\*\*, datë 13.6.2022, të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022.

<sup>41</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2022; shkresat nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2022.

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2022, e Ministrisë së Drejtësisë.

ii. Vepra penale e dytë “zotërim i paligjshëm armësh klandestine”, e kryer në datën 4.9.2012 në C.

iii. Vepra penale e tretë “zotërim i paligjshëm armësh”, e kryer në datën 4.9.2012 në C.

Për veprat penale të sipërcituara, shtetasi I.T është dënuar me 5 vjet burgim, gjobë 14.000 euro dhe reduktim i ritit për pranim të fajësisë.

- Gjithashtu, në lidhje me këtë shtetas janë dhënë dënime dytësore dhe masa të tjera si vijon:

a. Dënime dytësore:

- ndalim i ushtrimit të detyrave zyrtare për 5 vjet;
- konfiskim i automjetit.

b. Masat e sigurisë:

- konfiskim i mallrave të sekuestruara;
- konfiskim dhe shkatërrim i mallrave të sekuestruara.

- Në lidhje me ekzekutimin e dënimit, nga administrimi i të dhënave të regjistruara në certifikatën e gjendjes gjyqësore evidentohet se ka pasur ulje të dënimit për lirim të parakohshëm dhe ekzekutimi i dënimit është kryer nën regjimin e arrestit në shtëpi.

**49.3.** Bazuar në informacionin e siguruar nga Ministria e Drejtësisë dukej se deklarimi i subjektit në deklaratën për kontrollin e figurës nuk përputhet me informacionin e ardhur në lidhje me dënimin e dhënë nga Gjykata e Milanos dhe vuajtjen e dënimit nga vëllai i saj I. T. Subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në dokumentacion provues ligjor.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**50.** Subjekti ka shpjeguar se deklarin në deklaratën e kontrollit të figurës e ka kryer bazuar në komunikimin verbal me vëllain. Ajo ka theksuar se është përpjekur të zbatojë detyrimet ligjore në deklarin, bazuar në ligjin nr. 84/2016, konkretisht në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 në lidhje me deklarinin e veprave penale “krime të organizuara”, që parashikohen në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar afatin gjatë të cilit vëllai i saj ka vuajtur dënimin me burgim dhe, konkretisht, rreth 2 vjet e 6 muaj (pra, arrestuar në datën 4.9.2012, ndërsa në datën 17.3.2015 ka qenë në arrest shtëpie, lirim i parakohshëm), fakt i cili përputhet me dokumentacionin që referohet nga Komisioni.

**50.1.** Subjekti ka theksuar se nuk ka pasur për qëllim që të fshehë fakte dhe ka pretenduar se më shumë sesa një deklarin i pasaktë mund të cilësohet si një deklarin i paplotë referuar vendimit gjyqësor penal ndaj vëllait, por i plotë referuar ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 10192/2009. Në këtë këndvështrim deklarinin, subjekti ka cilësuar se veprat e tjera penale që citohen në vendimin gjyqësor si “armëmbajtja pa leje” (sipas nenit 278 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë) nuk përfshihen në kategorinë e veprave të cituara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe, për këtë arsye, nuk janë cituar në deklaratën përkatëse të kontrollit të figurës. Subjekti ka bashkëlidhur në cilësinë e provave certifikatën e gjendjes gjyqësore për shtetasin I.T, lëshuar në datën 4.10.2022, nga Gjykata e Zakonshme e Milanos, gjithsej 6 fletë, në gjuhën italiane dhe të apostiluara.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**51.** Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të paraqitura në Komision, si dhe pasi e dëgjoi në seancën dëgjimore, i çmon ato bindëse dhe të bazuara në ligj dhe në prova.

Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016 objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Sipas nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, personi i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa, në nenin 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, përcaktohen veprat penale që përfshihen në krimet e organizuara.

**51.1.** Referuar rrethanave të faktit ka rezultuar se subjekti ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 27.1.2017, bazuar në nenin 35, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj deklarate, pyetjes “*A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?*”, subjekti i është përgjigjur me “po”, duke cilësuar se në vitin 2016 vëllai i saj I.T ka pasur një proces penal në Milano, Itali, për posedim lëndësh narkotike (neni 283 i Kodit tonë Penal), për të cilin është dënuar dhe ka vuajtur dënimin prej rreth 2 vjet e 6 muaj burgim, në periudhën shtator 2012 – mars 2015. Bazuar në certifikatën e gjendjes gjyqësore të administruar nga hetimi i Komisionit, vëllai i subjektit rezultoi i dënuar për veprën penale “zotërim dhe shitje e paligjshme e lëndëve narkotike”, e cila sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë parashikohet nga neni 283 i Kodit Penal “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe në kuptim të ligjit nr. 10 192/2009 konsiderohet si krim i organizuar.

**51.2.** Nga hetimi i Komisionit rezultoi gjithashtu se vëllai i subjektit është dënuar po nga Gjykata e Milanos edhe për vepra të tjera penale, si “zotërim i paligjshëm armësh klandestine” dhe “zotërim i paligjshëm armësh”, por në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar parashikimeve ligjore mbi veprat penale që konsiderohen krim i organizuar, sipas ligjit nr. 10 192/2009, i ndryshuar, këto vepra penale çmohen se nuk përfshihen në kategorinë e krimeve të organizuara dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin e deklarimit të tyre, në kuptim të kriterit të kontrollit të figurës.

**51.3.** Për sa i përket deklarimit të subjektit në lidhje me dënimin e dhënë dhe të vuajtur nga vëllai i saj, trupi gjykues vëren se, pavarësisht se Gjykata e Milanos e ka dënuar në total me 5 vite burgim dhe gjobë 14.000 euro për kryerjen e tri veprave penale, ka pasur rrethana të pranimit të fajësisë nga ana e tij që e kanë çuar në uljen e dënimit. Për rrjedhojë, çmohet i besueshëm deklarimi i subjektit mbi vuajtjen e dënimit prej tij, rreth 2 vjet e 6 muaj.

**51.4.** Për sa analizuar më lart, trupi gjykues konkludon se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me deklarimin e saj sipas kërkesave të ligjit në fuqi dhe se deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit të Komisionit.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**52.** Në përfundim në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

**52.1.** Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, përveçse deklarimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me dënimin e vuajtur nga vëllai i saj në Itali.

**52.2.** Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor**

**53.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**53.1.** Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin të ligjit, si dhe shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Në vijim konstatohet se ajo ka përballuar me efikasitet ngarkesën e punës dhe se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

**54.** Hetimi i Komisionit për këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni në këtë kuadër; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**54.1.** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit, analizoji në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer në rivlerësimin e subjektit. Nga analizimi i tyre nuk u evidentuan *indicie* në kuptim të kriterit të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**54.2.** Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 16 denoncime<sup>43</sup> të depozituara nga publiku<sup>44</sup>. Nga administrimi dhe vlerësimi i tyre në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me 6 prej tyre, për të cilat paraqiti shpjegime si vijon:

**54.3.** Komisioni, pasi administroi prapësimet e subjektit, të shoqëruara nga shpjegimet dhe provat përkatëse, si dhe pasi i vlerësoi ato me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e konstatuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e publikut. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

## DENONCIMET

**55. Denoncim i paraqitur nga personi fizik “\*\*\*\*”,** protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “përfundimin e gjyqtares Nurjeta Pogaçe (Tafa) nga çështja civile nr. \*\*\*\*”. Nga analizimi i këtij denoncimi vihet re se denoncuesi ka kërkuar vënien në lëvizje të gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesës për përfundimin e subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar mbështetjen e kërkesës në shkaqe ligjore.

**55.1.** Komisioni, pas administrimit të fakteve, i kërkoi subjektit shpjegime edhe pse kërkesa e paraqitur i drejtohej gjykatës për administrimin e shkaqeve për përfundimin e saj, sipas neneve 72 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile.

**55.2.** Subjekti ka shpjeguar se pretendimet e denoncuesit janë të pabazuara dhe se kanë marrë përgjigje me vendimet përkatëse të dhëna nga gjykata lidhur me kërkesat për përfundim. Ajo ka shpjeguar se denoncuesi ka paraqitur pesë kërkesa për përfundimin e saj dhe të gjitha janë rrëzuar nga gjykata si të pabazuara. Për provuar shpjegimet e saj, subjekti paraqiti në cilësinë e provave fashikujt gjyqësorë lidhur me vendimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

---

<sup>43</sup> (1) Denoncim i paraqitur nga shtetasi F. V, person fizik, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018, me objekt “përfundimin e gjyqtares Nurjeta Tafa nga çështja civile nr. \*\*\*\*”; (2) denoncim i shtetases N. U, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2018, ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, me objekt “dhënie vendimi të padrejtë”; (3) denoncim i shtetasis M.S, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018, me objekt “dhënie vendimi të padrejtë”; (4) denoncim i shtetasis A.H, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2018, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe disa gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “favorizim i paditësit”; (5) denoncim i shtetasis A. M (avokat), protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, me objekt “verifikimin e disa shkeljeve; (6) denoncim i shtetasis K. D, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2020, paraqitur në formën e kallëzimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit dhe disa funksionarëve të tjerë publikë; (7) denoncim i shtetasis S.T, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2021, i cili ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, me objekt denoncimi për subjektin e rivlerësimit “verifikim të shkeljeve”; (8) denoncim i shtetasis F.G, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2020, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për moszhvillim të rregullt të procesit gjyqësor; (9) dy denoncime të shtetases B. B (avokate), protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2021 dhe me nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2021, me objekt “shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit”; (10) denoncim i shtetasis R.T, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, me objekt “dhënie vendim të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit”; (11) denoncim i shtetasis E.L paraqitur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, me objekt “dhënie të një vendimi të padrejtë në shkelje të ligjit dhe provave”; (12) tri denoncime të përsëritura të shtetases A. H paraqitur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, e cila, në cilësinë e viktimës, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje të përsëritura dhe vendim të paligjshëm; (13) denoncim i shtetasis L. Q paraqitur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, me objekt “kërkesë për t’u shprehur me vendim”.

<sup>44</sup> Njëmbëdhjetë denoncime të ardhura në adresë të Komisionit dhe pesë denoncime të ardhura pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të përcjella shkresërisht me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2022 dhe regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2022.

Durrës. Nga përmbajtja e vendimeve konstatohet se janë analizuar të gjitha pretendimet e denoncuesit dhe gjykatat nuk kanë gjetur asnjë shkelje procedurale për subjektin e rivlerësimit.

**55.3.** Komisioni, pas administrimit të fakteve dhe shpjegimeve, çmon se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm se asnjë pretendim i denoncuesit nuk është i bazuar, duke i mbështetur në fashikullin gjyqësor që i përket çështjes civile nr. \*\*\*.

**56. Denoncim i shtetasit M.S,** protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018. Denoncuesi, në cilësinë e përfaqësuesit gjyqësor të vajzës së saj E.L, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe prokurorin e çështjes në lidhje me vendimin e dhënë për lirimin e të pandehurit, duke pretenduar se e ka favorizuar atë.

**56.1.** Komisioni, duke i vlerësuar si *indicie* faktet e paraqitura në këtë denoncim, administroi<sup>45</sup> dosjen gjyqësore që i përket kësaj çështjeje, ku pas analizimit të saj i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit.

**56.2.** Subjekti ka paraqitur shpjegime të detajuara në lidhje me këtë çështje që nga regjistrimi i saj, shqyrtimi dhe deri në vendimin e dhënë prej saj. Subjekti ka theksuar se nuk ka favorizuar të pandehurin, por e ka dënuar mbi bazën e fakteve dhe provave, duke paraqitur para Komisionit faktin se gjykata e apelit ia ka lehtësuar më shumë dënimin, duke ia ulur atë, në raport me vendimin e dhënë nga subjekti.

**56.3.** Komisioni, pas administrimit të fakteve dhe shpjegimeve të subjektit<sup>46</sup>, bazuar në dokumentacionin provues<sup>47</sup>, çmon se subjekti i rivlerësimit arriti një nivel të bindshëm në lidhje me bazueshmërinë për marrjen e këtij vendimi dhe se asnjë pretendim i denoncuesit nuk rezultoi i bazuar.

**57. Denoncim i shtetasit A.H,** protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2018, i cili ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi. Denoncuesi është ankuar se subjekti ka favorizuar paditësin në lidhje me çështjen civile me të dhëna: shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kundër shtetasit A.H. Denoncuesi ka cituar një sërë faktesh ndaj subjektit të rivlerësimit, si: vendosjen e masës së sigurimit të padisë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe provat e administruara në gjykim; favorizimin e palës paditëse nëpërmjet rrëzimit të kërkesës për pezullim gjykimi, ndonëse ekzistonin kriteret ligjore për pranimin e kërkesës, pasi sipas denoncuesit ekzistonte një proces tjetër gjyqësor i lidhur me këtë proces gjyqësor, të cilët kishin ndërvarësi më njëri-tjetrit. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi faktet e pretenduara.

**57.1.** Subjekti ka shpjeguar se pretendimet e denoncuesit janë të pabazuara. Marrja e masës së sigurimit të padisë është realizuar për shkak se janë plotësuar kriteret ligjore të parashikuara në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe se Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.10.2017.

**57.2.** Në lidhje me pretendimin e favorizimit të palës tjetër, subjekti ka shpjeguar se asnjëherë nuk ka favorizuar ndonjë palë ndërgjyqëse, duke theksuar, ndër të tjera, se denoncuesi e ka paraqitur denoncimin si kundërvënie ndaj situatës së krijuar me trupin gjykues, ku ka kërkuar përjashtimin e tij dhe, në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke e gjobitur denoncuesin në masën 5.000 lekë

<sup>45</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022, ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>46</sup> Subjekti ka shpjeguar se e ka bazuar vendimin për uljen e dënimit në këto dokumente: epikrizë përcjellëse datë 18.6.2018, për shtetasin L. L, vulosur nga Spitali Rajonal Durrës, sipas të cilës rezultoi se i pandehuri ka qenë i shtruar në spital me hipertension arterial dhe i është rekomanduar ndjekja rregullisht e mjekimit ambulator; rekomandim datë 13.6.2018, i Qendrës Shëndetësore Nr. \*\*\*, Durrës.

<sup>47</sup> Kopje të fashikullit gjyqësor që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 12.7.2018; kopje të fashikullit gjyqësor që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 16.2.2018 (si pjesë e dosjes gjyqësore për zëvendësimin e masës së sigurimit); kopje të fashikullit gjyqësor që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 22.11.2018, lidhur me gjykimin e themelit.

për shkak se ka abuzuar, duke parashtruar një kërkesë të padrejtë për përjashtim. Shpjegimet e saj subjekti i mbështeti në prova<sup>48</sup>, të cilat, pasi u administruan, u vlerësuan bindëse nga trupi gjyqësor. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në ngarkim të denoncuesit është regjistruar edhe një procedim penal dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehuri A.H është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “fyerje e gjyqtarit”, parashikuar në nenin 318 të Kodit Penal dhe është dënua me 50.000 lekë gjobë.

**58. Denoncim i shtetasit S.T**, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2021, i cili ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, të cilët kanë gjykuar dhe hetuar në lidhje me konfliktet e pronësisë që ka pasur me familjen T. Ndër të tjera, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, denoncuesi ka denoncuar se subjekti nuk ka zhvilluar seancat gjyqësore dhe nuk ka kryer njoftimin ndaj tij. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi faktet e pretenduara.

**58.1.** Subjekti ka shpjeguar se pretendimi për mosnjoftim të denoncuesit është i pabazuar, duke paraqitur në mënyrë të detajuar dinamikën e çështjes dhe veprimet procedurale të ndjekura për njoftimin personalisht të denoncuesit në cilësinë e ndërhyrësit kryesor në çështjen civile nr. (\*\*\*) \*\*\*, datë regjistrimi 15.3.2018, ku ai ka rezultuar se ka qenë i pranishëm në të gjitha seancat e zhvilluara, çka e bën pretendimin e denoncuesit haptazi të pabazuar. Subjekti ka theksuar se të gjitha seancat kanë qenë me regjistrim audio, duke u verifikuar lehtësisht prania e denoncuesit në gjykim. Komisioni analizoi shpjegimet dhe provat<sup>49</sup> e paraqitura nga subjekti dhe i gjeti ato të bazuara.

**59. Dy denoncime të shtetasës B.B (avokate)**<sup>50</sup>, me objekt “shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit”, si: veçim të padisë në kundërshtim me nenin 158/1, pika 2, germa “ë”, për arsye të mospagesës së tarifës ekstra të padisë, kërkuar nga gjykata për 11 të paditurit, shkelje të nenit 154/a<sup>51</sup> të Kodit të Procedurës Civile, pasi e ka kthyer padinë me të meta, pa e shënuar në padi datën e paraqitjes dhe, për rrjedhojë, sipas denoncueses të gjitha veprimet e mëpasshme të kryera nga subjekti konsiderohen të jenë kryer jashtë seance.

**59.1.** Komisioni administroi aktet<sup>52</sup> e paraqitura nga denoncuesja, si dhe shqyrtoi vendimin e subjektit të rivlerësimit, administruar në formë të shkurtuar nga hetimi i Komisionit<sup>53</sup>. Pas verifikimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncueses.

**59.2.** Subjekti ka shpjeguar në detaje në lidhje me regjistrimin dhe ecurinë e kësaj çështjeje, e cila përmbante 12 kërtime të mëvetshme dhe, konkretisht, detyrimin e secilit prej të paditurve që të lironin dhe dorëzonin sipërfaqen respektive që kishin zënë me ndërtime pa leje, sipas pretendimit të paditëses. Paraqitja e një padie të vetme në vend të 12 padive (1 padi për secilin nga të paditurit) nuk e përjashton paditësin nga detyrimi i pagimit të tarifës gjyqësore për secilën palë të paditur, pasi mënyra e shqyrtimit të tyre (nëse do të shqyrtohen secila më vete

<sup>48</sup> Fashikull gjyqësor që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 5.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (bashkëlidhur do të gjeni kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi datë 26.12.2018, kallëzim penal të paraqitur ndaj denoncuesit A.H datë 24.12.2018, dhe vendimin nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, të Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës); vendim nr. \*\*\*, datë 5.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>49</sup> Kopje të akteve në përmbajtje të fashikullit gjyqësor që i përket ndërhyrësit kryesor S T.

<sup>50</sup> Protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2021.

<sup>51</sup> Kur kërkesëpadija nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre (kreu I-hartimi, paraqitja në gjykatë, njoftimi i padisë dhe veprimet përgatitore), gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime.

<sup>52</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 7.12.2020, “Për konstatimin e të metave të kërkesëpadiës”; kërkesë për pezullim të veçimit të çështjes deri në marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 11.4.2021; memo drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2020; vendim nr. \*\*\*, datë 11.1.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për veçimin e kërtimeve; ankim kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 11.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>53</sup> Administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2022, dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2022.



apo do të shqyrtohen së bashku në një gjykim të vetëm) nuk mund të shërbejë si mënyrë për të shmangur pagesën e tarifës gjyqësore. Subjekti ka shpjeguar se ia ka komunikuar denoncueses faktin e pagesës së tarifës gjyqësore, duke e arsyetuar atë dhe vetëm kur është njohur me qëndrimin refuzues të denoncueses për të mos paguar tarifat gjyqësore ka proceduar me veçimin e kërtimeve.

**59.3.** Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit, Komisioni i çmon ato të bazuara në prova<sup>54</sup>, duke i gjetur të pabazuara pretendimet e denoncueses.

**60. Tri denoncime të përsëritura të shtetases A.H,** paraqitur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit<sup>55</sup>, e cila, në cilësinë e viktimës, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje të përsëritura dhe vendim të paligjshëm, nga të cilat është cenuar jo vetëm procesi gjyqësor, por edhe të drejtat e saj në çështjen penale me palë: kërkues Prokuroria e Rrethit Durrës; i pandehur A.R; dhe viktimë A. H, me objekt “deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale ‘përdorim i dokumenteve të falsifikuara’”. Denoncuesja ka cituar shkeljet e kryera nga subjekti, si tejkalim të afateve në zbardhjen e vendimit, tehzgjatje të procesit prej 12 seancash gjyqësore pa arsye ligjore, apo shkelje etike.

**61.** Pas analizimit të dosjes gjyqësore<sup>56</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime mbi pretendimet e denoncueses, duke u fokusuar më shumë te koha e arsyetimit të vendimit dhe duke i kërkuar të provohet me dokumentacion provues dorëzimi i vendimit nga subjekti i rivlerësimit.

**61.1.** Subjekti ka shpjeguar se pretendimet e denoncueses janë të pabazuara. Për sa i përket dorëzimit të vendimit, subjekti ka sqaruar se vendimi gjyqësor ndaj të pandehurit A. R është shpallur në datën 6.6.2019 dhe sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 afati i arsyetimit të vendimit është 30 ditë. Ndaj të pandehurit nuk ka qenë caktuar masë sigurimi dhe, për këtë arsye, afati i dorëzimit të vendimit ka qenë data 6.7.2019 (30 ditë sipas nenit 382/1 të Kodit të Procedurës Penale). Sipas fletës së regjistrimit themeltar penal rezulton se vendimi është dorëzuar nga sekretarja gjyqësore në datën 8.7.2019, për arsye se data 6.7.2019 ka qenë ditë e shtunë, ndërsa data 7.7.2019 ka qenë ditë e diel. Vetë dosja gjyqësore e përfunduar është dorëzuar në sekretari në datën 10.7.2019, brenda 2 ditëve nga dorëzimi i vendimit. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës kopje të fletës së regjistrimit themeltar të vulosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas së cilës provohet se arsyetimi i vendimit është kryer nga subjekti brenda afatit ligjor.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**62.** Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

---

<sup>54</sup> Fashikujt gjyqësorë që u përkasin vendimeve nr. \*\*\*, datë 5.5.2021, nr. \*\*\*, datë 9.4.2021, nr. \*\*\*, datë 9.4.2021 dhe nr. \*\*\*, datë 9.4.2021.

<sup>55</sup> Protokolluar pranë ONM-së me nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2019, nr. \*\*\* prot. ex \*\*\*, datë 15.5.2020, nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021, të përcjellë shkresërisht pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2022 dhe regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2022.

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2022, e Komisionit dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**62.1.** Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa) ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, si dhe në nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Nurjeta Pogaçe (Tafa), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 2.11.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Pamela QIRKO**  
Relatore

**Brunilda BEKTESHI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*

## ANEKSI 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	22.10.2013 – 31.12.2013	2014	2015	2016
<b>A) PASURI</b>	<b>0</b>	<b>883,608</b>	<b>497,073</b>	<b>-900,181</b>
Automjet i llojit “****”, me targa AA ***		308,242		
Automjet i llojit “****”, me targa AA ***				185,000
Automjet i llojit “****”, me targa AA ***			58,000	
Ndryshim likuiditeti		575,366	439,073	-1,085,181
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>0</b>	<b>883,608</b>	<b>497,073</b>	<b>-900,181</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>151,111</b>	<b>1,345,938</b>	<b>1,689,976</b>	<b>1,708,655</b>
Të ardhura nga paga e subjektit si pedagoge në A. U	15,300	90,000		
Të ardhura nga paga e subjektit gjyqtare	95,869	989,886	981,085	1,051,122
Të ardhura nga paga e subjektit si eksperte teknike pranë Kuvendit të Shqipërisë			449,439	
Të ardhura nga pensioni/invaliditeti, nëna e subjektit	39,942	266,052	259,452	259,452
Të ardhura nga paga, vëllai i subjektit (K.T)				398,081
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>81,137</b>	<b>727,247</b>	<b>672,828</b>	<b>1,770,822</b>
Shpenzime minimale jetike	81,137	659,994	672,828	822,822
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit		67,253		
Shpenzime mjekësore				948,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	69,974	-264,917	520,075	838,014